

Është inauguruar shkolla në Talinoc të Ferizajt

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, kryetari i Komunës, Agim Aliu, drejtori i Arsimit në Komunën e Ferizajt, Afrim Llabjani dhe drejtoresha e shkollës Shqipe Zeqiraj-Emini, kanë bërë përrurimin e SHFMU “Dy Dëshmorët” në Talinoc të komunës së Ferizajt.

Ministrja, Arbërie Nagavci ka thënë se, investimi i më shumë se 1 milion euro për ndërtimin e objektit shkollor dhe me inventar në vlerë afro 16 mijë euro tregon përkushtimin serioz të Qeverisë për të përmirësuar kushtet e arsimit në vend.Â

“Një shkollë e re dhe e pajisur mirë është thelbësore për një mësim efektiv dhe për krijimin e një ambienti edukativ tërheqës dhe produktiv”, tha ndër të tjera ministrja Nagavci.

Ministrja Nagavci tha se, ndërtimi, rinovimi, adaptimi dhe funksionalizimi i shumë objekteve shkollore është një arritje e rëndësishme që kontribuon në cilësinë e arsimit.

Ministrja Nagavci po ashtu theksoi rëndësinë e arsimit parauniversitar, duke përfshirë klasat nga e para deri në të dymbëdhjetën, vite kur fëmijët formohen dhe zhvillojnë aftësitë bazë për jetën.

Ndërsa, kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu theksoi se mësimi në një shkollë të re dhe me kushte të përshtatshme do të ndikojë pozitivisht në përvojën arsimore të fëmijëve dhe në cilësinë e arsimit që ata marrin. Aliu gjithashtu tha se, kjo arritje është një dëshmi e angazhimit dhe bashkëpunimit të pushtetit lokal me atë qëndror, për të investuar në të ardhmen e komunitetit dhe për të siguruar që fëmijët të kenë një ambient të shëndetshëm të mësuar.